



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KD. NR. 3-17/2021

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga Besian Syla - Kryetar, Agron Curri dhe Bajram Lajqi – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 16/2020 të dt. 26.05.2021, të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, kundër avokatit _____ nga _____ me adresë në _____, rr. _____, në bazë të nenit 51 paragrafi 1, nënparagrafi, 1.2. të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, lidhur me nenin 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së dhe nenit 35 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit kryesor disiplinor, me dt. 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, avokat _____ nga _____, me adresë në _____, rr. _____, me nr. të reg. _____ të OAK-së.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

Me dt. 14.02.2020 në sheshin "_____" në _____, ka ndërmarrë veprime jo etike, kur ka shqelmuar lypsin si dhe kartonin me të holla tij.

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë, sepse me veprimin e bërë ka cenuar autoritetin e avokatisë.

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në pajtim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatinë, nenit 123 paragrafi 3 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit, avokatit _____ i shqipton masën disiplinore:

G J O B Ë

I. Në shumën prej 2,500.00 € (dymijë e pesëqind) Euro.

II. Obligohet i paraqituri _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) Euro.

III. Pagesa gjobës dhe paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Me dt. 26.05.2021, Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, në Zyrën për Komisionin Disiplinor të OAK-së, ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 16/2020, kundër të paraqiturit, av. _____ nga _____, me adresë në _____, _____, _____, me nr. të reg.344/1992 të OAK-së, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore kundër tij, për shkak se i njëjti ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë.

Kolegji disiplinor, me dt. 24.05.2021, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi propozimin e Prokurorit Disiplinor nr. 16/20, dt. 26.05.2020, me provat e bashkëngjitura, konstatoi se ekziston arsyeja bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____.

Kolegji Disiplinor, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit kryesor më datën 28.06.2021, ka marrë Vendimin me nr.3-4/2021, me të cilin të paraqiturin avokatin _____ e ka shpallur përgjegjës dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë, si dhe e ka obliguar që t'i paguaj shpenzimet e paushallit të procedurës disiplinore.

Komisioni për Ankesa i Odës së Avokatëve të Kosovës, pas trajtimit të ankesave të parashtruara nga palët në këtë çështje disiplinore, me vendimin KA.nr.3-13/2021, dt.21.09.2021, këtë çështje e ka kthyer në rivendosje.

Kolegji disiplinor, sipas rekomandimeve të Komisionit për ankesa, me datën 24.11.2021, ka mbajtur seancën kryesore dëgjimore, në çështjen disiplinore të kthyer në rivendosje, në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, z. Rexhep Veseli dhe dëshmitarit z. _____ në mungesë të të paraqiturit av. _____ i cili e kishte pranuar ftesën në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Kolegji Disiplinor pas verifikimit dhe konstatimit se i paraqituri av. _____ është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor, ndërsa i njëjti nuk prezanton në seancë dhe lidhur me mungesën e tij i njëjti në kohën kur është paraparë të mbahet seanca ka dorëzuar kërkesën për shtyrje të seancës, e cila kërkesë është refuzuar nga ana e Kolegjit Disiplinor për shkak se Kolegji ka vlerësuar se kjo kërkesë nuk është e mbështetur në prova konkrete dhe bindëse, si dhe tendencë e të paraqiturit për zvarritje të procedurës, sepse provat e bashkëngjitura kërkesës për shtyrje të seancës, përkatësisht ftesat për seanca gjyqësore të caktuara për të njëjtën datë ishin të caktuara të mbahen në ora 09:30, ndërkaq seanca e shqyrtimit disiplinor ishte caktuar të mbahet në ora 15:00.

Kolegji Disiplinor vendosi që seanca e shqyrtimit kryesor të mbahet në mungesë të të paraqiturit av. _____, pasi që për këtë janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 28 paragrafi 2 i Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

Kolegji Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 29, 30, 31, 33 dhe 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore dhe deklarimit të Prokurorit Disiplinor të OAK-së se nuk kishte vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor me nr. 16/20 të datës 26.05.2020.

Prokurori Disiplinor, z. Rexhep Veseli deklaroi: Për këtë çështje fillimisht ZPD ka qenë duke e bërë ndjekjen sipas detyrës zyrtare dhe në ndërkohë për të njëjtën çështje ZPD ka pranuar edhe dy fletëparaqitje nga z. [] me datën 18.02.2020 dhe nga [] ([]), të datës 03.03.2020. ZPD konform nenit b58 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka bashkuar procedurën pasi që ka qenë çështja e njëjtë, i paraqituri i njëjtë por me paraqitës të ndryshëm si dhe ZPD-në Ex-Officio. Pas këtij vendimi të datës 08.04.2021 procedura është udhëhequr me shenjën e fletëparaqitjes së parë me nr.16/2020. ZPD qëndron prapa Propozimit me nr.16/2020 të datës 26.05.2021, më të cilën ka kërkuar që të zhvillohet procedura disiplinore sepse avokati [] me datën 14.02.2020 ka vepruar në kundërshtim me nenin 119 të statutit të OAK-së dhe nenin 8 të KEPA-së, sepse ka shqelmuar kartonin me të hollat e një lypsari dhe me këtë veprim ka cenuar rëndë autoritetin e Avokatisë, andaj ZPD kërkon nga Komisioni Disiplinor që të njëjtit t'i shqiptohet masa disiplinore konform normativës së OAK-së. Ndërsa në pyetjen e Kryetarit të Kolegjit Disiplinor se a qëndron pranë ndjekjes disiplinore sipas detyrës zyrtare. Prokurori Disiplinor deklaroi se, po qëndrojë pranë ndjekjes disiplinore sipas detyrës zyrtare.

Kolegji disiplinor pas deklarimit të Prokurorit disiplinor, vazhdoi me procedurën e administrimit të provave, me ç'rast u lexuan: Propozimi i ZPD-së nr.16/2020 i dt.26.05.2021; Fletëparaqitja nr.16/2020 e datës 18.02.2020; Njoftimi nr.16-1/2019 i dt.25.06.2020; Përgjigje nga [] nr.16-2/2019 e dt.24.07.2020; Njoftimi nr.70-2/2019 e datës 17.06.2020; Fletëparaqitja nr.23/2020 e datës 03.03.2020; Njoftimi nr.23-1/2020 i dt.11.03.2021 së bashku me fletëkthesën e PTK- së; Vendimi 16/20 dhe 23/20 i datës 08.04.2021; E-maili i datës 15.02.2020; Urgjenca e datës 07.04.2021; u bë shikimi i video incizimit nga CD, si dhe u dëgjua dëshmitari

Dëshmitari [] deklaroi: Komision i nderuar dhe i respektuar përveç asaj që kam cekur në fletëparaqitje deklaroi se me datën 14.02.2020 kam qenë në [] në afërsi prej 10 metrave nga vendi i shkelmimit të kutisë së kartonit me lekët në centë të lypsarit nga avokati []. Këtë veprim të avokatit [] e kam parë prej fillimit deri në përfundim të ngjarjes. Unë kam qenë në sheshin [] kur avokati [] ka ardhur nga drejtimi prej [] në drejtim të sheshit [] dhe kur ka ardhur te ish ndërtesa e Komitetit Krahinorë ju ka ofruar lypsarit i cili ishte ulur në shesh për të kërkuar lëmoshë, dhe unë fillimisht mendova se po i jep ndonjë të hollë – lëmoshë, por i njëjti e goditi me shqelm kartonin në të cilin lypsarit i hudhnin të holla kalimtarët ku ju kanë shpërndarë të gjitha monedhat e imta nëpër shesh dhe me atë rast unë mbeta i habitur dhe u shqetësova tej mase me veprimin që e pashë duke e bërë avokati [].

Kolegji disiplinor pas administrimit të provave të cilat kaluan pa vërejtje nga prokurori disiplinor, si dhe dëgjimit të dëshmitarit, vazhdoi me deklaratat përmbyllëse të palëve prezente.

Prokurori Disiplinor në deklaratën përmbyllëse deklaroi: Pas administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarit dhe shikimit të video incizimit (CD) u vërtetua se i paraqituri av. [redacted] ka bërë shkelje të rëndë pasi që u konstatua se ka shqelmuar kartonin me të holla të një lypsari e së bashku me të në video incizim vërehet se i njëjti fillimisht e shqelmon lypsin dhe pastaj me kartonin me të holla. Andaj ZPD konsideron se janë përmbushur kushtet që të paraqiturit av. [redacted] t'i shqiptohet masë disiplinore konform normativës së OAK-së.

Kolegji Disiplinor, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit në tërësi të rrethanave të rastit, propozimit të Prokurorit Disiplinor dhe provave të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, deklaratave përmbyllëse të prokurorit disiplinor dhe të ushtruesve të fletëparaqitjeve, erdhi në përfundimin se veprimi i të paraqiturit - **kur ka shqelmuar lypsin si dhe kartonin me të holla të tij**, paraqet shkelje të nenit 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë dhe Praktikantë, **dhe se avokati [redacted], është përgjegjës për këtë shkelje**. Veprimet e të paraqiturit av. [redacted] sipas nenit 119 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 8 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë dhe Praktikantë, Kolegji e konsideroi si shkelje të rëndë, pasi me këto veprime të ndërmarra nga ana e të paraqiturit është cenuar autoriteti i avokatisë, dhe se këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat dhe frymën e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Deri të ky përfundim kolegji disiplinor erdhi pasi shqyrtoi të gjitha provat e lartëcekura dhe deklaratimet e palëve prezente në shqyrtim kryesor, ku nga këto prova, sidomos nga dëgjimi i dëshmitarit [redacted], e në veçanti nga shikimi i CD-së me video incizim, shihet qartë se i paraqituri në sheshin [redacted], pas një komunikimi të shkurtër me lypsin, fillimisht e shqelmon atë pastaj i'a shqelmon edhe kartonin me të holla. Nga ky video incizim vërtetohen edhe pretendimet prokurorit disiplinor, se i paraqituri ka ndërmarr veprime jo etike, të cilat kanë ngjallur pa kënaqësi në opinoin publik, me ç'rast si rrjedhojë ka ardhur edhe deri tek ushtrimi i fletëparaqitjeve nga fletëparaqitësit e lartëcekur, si dhe pa dyshim është cenuar autoriteti i avokatisë.

Megjithatë, Kolegji të paraqiturit i shqiptoi masën gjobë të paraparë për këtë shkelje në nenin 123 paragrafi 2 të Statutit të OAK-së, dhe atë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Kolegji e vlerësoi si rrethanë lehtësuese të kaluarën disiplinore të të paraqiturit, ku sipas shënimeve të Odës, i njëjti nuk figuron të ketë vendim të formës së prerë për ndonjë masë disiplinore në të kaluarën. Ndërsa si rrethana rënduese Kolegji gjeti se në veprimet e të paraqiturit manifestohet shkallë e lartë e dashjes nga ana e të paraqiturit për të ndërmarr veprime të tilla, mënyrën dhe vendin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve si dhe dëmin e shkaktuar imazhit dhe autoritetit të avokatisë.

Kolegji vendosi për këtë lloj dhe lartësi të masës, me bindjen se është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore, e me të cilën synohet ruajtja e nderit, dinjitetit dhe prestigjit të avokatisë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin, sepse shpenzime për ekspert dhe përkthyes nuk kishte. Ndërsa lidhur me kërkesën e parashtruar nga dëshmitari për kompensimin e shpenzimeve, Kolegji Disiplinor e pati të pamundurë të vendosë për shkak se nuk kishte prova lidhur me llojin dhe


lartësin e shpenzimeve. Vendimin për paushallin, u mor në bazë të nenit 37 paragrafi 1, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikantë.

Me bindjen e plotë se, vendimi i Kolegjit në këtë çështje disiplinore është krejtësisht në përputhje me Ligjin e Avokatisë dhe normativën e Odës, me bindjen se, për këtë çështje nuk mund të vendosej më mirë dhe më drejt se kështu, Kolegji vendosi ashtu si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. NR. 3-17/2021, dt. 24.11.2021


Procesmbajtësja

Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetar i Kolegjit Disiplinor

Av. Besian Syla



KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.